



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

RAPORTI PËRMBLEDHËS I AKREDITIMIT

PËR SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE “KRISTO ISAK”, BERAT

QERSHOR 2026

I. BAZA LIGJORE

Procesi i Akreditimit për ofruesit e arsimit dhe formimit profesional mbështetet në Ligjin Nr. 15-2017 datë 16.02.2017 *“Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në Urdhrin nr. 845, datë 3.7.2025 për miratimin e *“Rregullores për Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit Profesional”* të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në rregulloren e brendshme *për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve* dhe në urdhrin e brendshëm të AKAFPK-së me nr. 33, datë 23.07.2025 *“Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të AFP-së”*.

II. KONTEKSTI I OFRUESIT

Histori e shkollës:

Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak” Beart, është një institucion publik i arsimit profesional, me fokus në përgatitjen e të rinjve përmes kualifikimeve të orientuara sipas kërkesave të tregut të punës. Institucioni e ka nisur aktivitetin e tij në vitin 1967, si vijimësi e një zhvendosjeje të pjesshme të Shkollës Ekonomike të Tiranës në qytetin e Beratit. Në fillimet e saj, shkolla operoi me kualifikimin ekonomik të orientuar nga bujqësia. Më vonë, gjatë viteve 1967–1990, u ofruan kualifikime si agronomi, veterinar, zooteknikë dhe ekonomi bujqësore. Në periudha të ndryshme, shkolla ka përfshirë gjithashtu programe pedagogjike (1998–2008), gjimnaz të përgjithshëm (deri më 2002) dhe gjimnaz gjuhësor (2003–2014).

Prej vitit 2007 e në vijim, shkolla është përqendruar në arsimin profesional, duke konsoliduar drejtimet Ekonomi-Biznes dhe Hoteleri-Turizëm, ndërsa në vitin 2017 u shtua edhe drejtimi mësimor Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, si përgjigje ndaj kërkesave të reja të komunitetit dhe zhvillimeve ekonomiko-sociale. Aktualisht, shkolla ofron drejtimet arsimore me profilet përkatëse profesionale si, Ekonomi-Biznes, Hoteleri-Turizëm dhe Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, përmes metodave bashkëkohore të mësimdhënies, partneriteteve me bizneset dhe pjesëmarrjes aktive në projekte zhvillimore.

Aktualisht, shkolla ka nënshkruar 115 marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe institucione shtetërore, prej të cilave 62 janë biznese aktive ku nxënësit zhvillojnë praktikën profesionale. Këto partneritete kanë ndihmuar në rritjen e cilësisë së arsimit si dhe në fuqizimin e lidhjes me tregun e punës. Përmes përfshirjes së nxënësve në konkurse kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikave profesionale në bashkëpunim me biznese, shkolla ka rritur ndjeshëm mundësitë e punësimit të nxënësve të diplomuar. Shkolla e Mesme Profesionale “ Kristo Isak ”, Berat ofron kualifikimet profesionale, sipas niveleve përkatëse në KSHK:

1. “Shërbime Sociale dhe Shëndetësore”, Niveli II në KSHK, O-II-22
2. “Shërbime Kujdesi për Fëmijë”, Niveli III në KSHK, O2-III-24

3. “Shërbime Sociale dhe Shëndetësore”, Niveli IV në KSHK, O-IV-25
4. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli II në KSHK, G-II-22
5. “Shërbime në Hotel dhe Restorant”, Niveli III në KSHK, G5-III-24
6. “Kuzhinë-Pastiçeri”, Niveli III në KSHK, G2-III-22
7. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli IV në KSHK, G-IV-25
8. “Ekonomi-Biznes”, Niveli II në KSHK, L-II-21
9. “Tregti”, Niveli IV në KSHK, L6-IV-23
10. “Kuzhinë” (Arsim i dyfishtë), Niveli III në KSHK, G8-III-24

III. PËRMBLEDHJA E PROCESIT

Ofruesi Publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak” Berat, depozitoi kërkesën për akreditim pranë AKAFPK-së me nr. 577 prot. datë 24.7.2025, me lëndë “Kërkesë për Akreditim, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 271 prot., më datë 28.7.2025. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në zbatim të Urdhrit nr. 845/2025 të MEKI nisi procesin e Akreditimit duke ngritur dhe konsoliduar grupin e vlerësuesve të jashtëm (GVJ), përmes një procedure të miratuar më parë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të akreditimit të Shkollës së Mesme Profesionale “Kristo Isak”, Berat me qëllim sigurimin e një analize të plotë dhe të saktë ka përdorur **metodologjinë e bazuar në hapat e mëposhtëm:**

- Studimi i dosjes së dokumentave të dorëzuar në AKAFPK dhe i dokumentacionit të kërkuar gjatë vizitave në terren.
- Takime direkte të GVJ-së me drejtorinë e ofruesit, bizneset partnere, përfaqësues të nxënësve, përfaqësues të prindërve, mësimdhënës, staf mbështetës.
- Përpunimi i pyetësorëve të plotësuar nga grupet e interesit të ofruesit (Google Form).
- Shkrimi i raportit duke punuar në grup.
- Katalogimi i evidencave të grumbulluara gjatë vizitave tek ofruesi dhe organizimi i tyre në format elektronik.
- Dorëzimi i raportit paraprak të hartuar nga GVJ në AKAFPK bashkë me evidencat argumentuese.
- Marrja e komenteve nga AKAFPK ,dhe rishikimi i raportit nga GVJ.
- Hartimi dhe dorëzimi i raportit me rishikimet dhe sugjerimet përkatëse.

Instrumentet e vlerësimit që u përdorën:

Vëzhgimi:

Janë vëzhguar nga GVJ-ja mjediset e ofruesit, dosjet me dokumentacionin e njësisë së zhvillimit dhe koordinatoreve përkatës, dosjet me dokumentacionin e vetëvlerësimit, dosjet me dokumentacionin

e akreditimit, dokumentacioni i sekretarisë, dokumentacioni i financës, programet lëndore të kurrikulës së përgjithshme, skeletkurrikulat, planet vjetore të lëndëve dhe moduleve profesionale, listat e kontrollit për vlerësimin e moduleve, sistemin SMIP për vlerësimin dhe certifikimin e nxënësve në nivele të ndryshme. Janë vëzhguar procesverbale të provimeve të niveleve, tabela të maturës shtetërore, rezultatet e gjurmimit, pyetesorët e kënaqësisë.

Intervista dhe pyetesorë:

- Intervista dhe pyetesorë të standardizuara me drejtorinë, koordinatorët e NJZH, stafin mbështetës, stafin mësimdhënës, nxënësit, komunitetin e prindërve dhe komunitetin e biznesit.

Puna në grup:

- Është dakordësuar ndarja e punëve mes anëtarëve të grupit dhe janë shkëmbyer informacionet dhe dokumentacionet e mbledhura.

Organizimi i punës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga tre anëtarë, organizoi punën me ndarje të qarta të detyrave për grumbullimin, analizën dhe përpunimin e dokumentacionit. Diskutimet për gjetjet dhe rekomandimet u zhvilluan në mënyrë bashkëpunuese duke siguruar vendimmarrje të përbashkët. Koordinimi u realizua duke kombinuar bisedat fizike me komunikimin online, dhe përmes kontaktit të vazhdueshëm me koordinatorin e procesit pranë AKAFPK për çdo çështje që kërkonte sqarim. Ky organizim siguroi një proces efikas dhe një analizë të plotë të rezultateve.

Mbyllja e procesit.

Në përfundim, metodologjia e ndjekur ka mundësuar një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të balancuar të performancës së ofruesit të AFP-së, duke siguruar bazën e nevojshme faktike për konkluzionet, vlerësimet dhe rekomandimet e paraqitura në raport.

IV. GJETJET PËR 5 FUSHAT E CILËSISË

Fusha 1 Menaxhimi.

Drejtnesit e Ofruesit të AFP-së dhe organet e krijuara për sigurimin e funksionimit të tij si dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi, bashkëpunojnë me përfaqësues të grupeve të interesit. Veprimtaria dhe kontributi i përfaqësuesve të grupeve të interesit është përgjithësisht i dokumentuar. Plan i Vjetor është hartuar nga Drejtoria në bashkëpunim me Njësinë e Zhvillimit duke respektuar të gjitha kërkesat ligjore. Plan i vjetor bazohet në planin afatmesëm. Shkolla harton metodologjitë, procedurat dhe instrumentet për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënësve, të cilat përfshijnë analiza statistikore të frekuentimit dhe të rezultateve, vëzhgime të mësuesve gjatë orës mësimore, sipas shpeshësisë së përcaktuar me ligj. Drejtoria e Ofruesit të AFP-së ka krijuar një sistem për menaxhimin e dokumenteve për identifikimin, ruajtjen, mbrojtjen, tërheqjen, mbajtjen e të gjitha të dhënave dhe dokumenteve të

përcaktuara me ligj. Nga vëzhgimet e bëra në dokumentacionin e ofruesit të AFP-së vihet re se nuk ka rregullsi në procedurën e protokollimit të dokumentacionit. Veprimtaria e Njesisë së Zhvillimit është e dokumentuar. Shkolla ka procedura ankimimi të cilat duhet të dokumentohen më mirë dhe të pasqyrohen në të gjitha vendimet dhe procedurat që kryen drejtoria e ofruesit dhe organizmat e tjerë pjesë të menaxhimit institucional.

Fusha 2 Marrëdhënia dhe bashkëpunimi.

Ofruesi i AFP-së ka bërë një analizë të detajuar të bashkëpunimit me bizneset. Megjithatë, në planin vjetor dhe në planin afatmesëm nuk identifikohen qartësisht bizneset me të cilat bashkëpunohet. Drejtoria dhe personeli përgjegjës i shkollës komunikojnë rregullisht me komunitetin lokal të biznesit, e informojnë atë mbi veprimtarinë dhe rezultatet e ofruesit të AFP-së, mbledhin informacion dhe ruajnë të dhëna mbi rezultatet e partneritetit. Shkolla vë në dispozicion ambientet e veta të specializuara për aftësimin praktik të nxënësve për të gjitha kualifikimet sipas standardeve të profesionit dhe standardeve të kualifikimeve profesionale, në përputhje me përshtatësit e niveleve të KSHK-së, si dhe mbledh informacione sistematike nga partnerët mbi aktivitetet e të nxënësve në vendin e punës dhe rezultatet e tij. Bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqërinë civile nuk është i identifikuar qartë në planin Afatmesëm dhe Planin vjetor. Ofruesi i AFP-së merr pjesë në rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare të institucioneve arsimore si dhe në projekte të përbashkëta të financuara në nivel kombëtar, evropian e ndërkombëtar.

Fusha 3 Kurrikula e zbatuar.

Kurrikula e ofruesit të AFP-së hartohet dhe zbatohet në përputhje me standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve profesionale dhe përshtatësit e niveleve të KSHK-së. Planet mësimore dhe programet zhvillohen sipas procedurave të qarta institucionale dhe koordinimit ndërmjet drejtimit, departamenteve dhe ekipeve lëndore. Procesi mësimor respekton parimet e barazisë, përfshirjes dhe mosdiskriminimit, ndërsa ofertat e kualifikimeve përcaktohen sipas nevojave të tregut të punës, në bashkëpunim me bizneset dhe partnerët lokalë. Mësimdhënësit shfrytëzojnë në mënyrë efektive infrastrukturën, laboratorët, pajisjet dhe materialet didaktike për realizimin e programeve. Kurrikula synon zhvillimin e kompetencave profesionale dhe kompetencave kyçe, si aftësitë e komunikimit, shkrim-leximit, numerike dhe digjitale. Praktika profesionale planifikohet dhe realizohet në bashkëpunim me bizneset, duke u ofruar nxënësve përvojë në kushte reale pune. Drejtoria siguron tekste, materiale mbështetëse, pajisje dhe burime të teknologjisë së informacionit, duke mbështetur zbatimin cilësor të mësimdhënies dhe vlerësimit.

Fusha 4 Mësimdhënia dhe të nxënësve.

Mësimdhënësit realizojnë planifikimin ditor sipas kriterëve. Ata paraqesin objektivat e të nxënësve dhe rezultatet e të nxënësve për çdo njësi mësimore, në përputhje me kurrikulën e planifikuar të institucionit. Procesi i mësimdhënies dhe i mësimnxënies garanton arritjen e rezultateve të planifikuara të të nxënësve dhe ka përshtatshmëri me përdorimin e materialeve dhe burimeve të

mësimdhënies dhe nxënies. Procesi i mësimdhënies dhe i mësimnxënies garanton zhvillimin e kompetencave kyçe.

Fusha 5 Vlerësimi.

Mësimdhënësit përdorin metodologjitë dhe instrumentet e planifikuara për vlerësimin e vazhduar, të cilat mbulojnë rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e përcaktuara nga standardet. Të dhënat dhe evidencat mbi rezultatet e vlerësimit mbledhen dhe regjistrohen rregullisht. Planifikimi dhe organizimi i provimeve të Niveleve dhe të Maturës Shtetërore Profesionale realizohet në përputhje me legjislacionit në fuqi. Drejtoria e shkollës merr masa për sigurimin e mjediseve, infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe materiale për organizimin e provimeve. Rezultatet e vlerësimeve nuk publikohen në mjediset e institucionit.

V. REKOMANDIMET E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR

- Rekomandohet që shkolla të vazhdojë procesin për pajisjen me dokumentacionin historik të hapjes si ofrues publik i AFP-së.
- Rekomandohet të rifreskohet vula e institucionit në përputhje me emërtimin zyrtar të ofruesit të AFP-së.

FUSHA 1. MENAXHIMI

- **Rekomandim Nr. 1 (kriter bazë 1.1.1.1)**
Për vitin mësimor 2026-2027 rregullorja e bordit drejtues duhet të jetë e firmosur nga kryetari i bordit.
- **Rekomandim Nr. 2 (kriter bazë 1.1.2.2)**
Në rishikimin e ardhshëm të planit afatmesëm duhet të përfshihen më mirë rezultatet e funksionimit të strukturave të brendshme të menaxhimit dhe konsultimit (vendime, kërkesa, rekomandime).
- **Rekomandim Nr. 3 (kriter bazë 1.2.1.5)**
Rekomandohet që në planin e ardhshëm afatmesëm të hartohen objektiva specifike për çdo kualifikim profesional që ofron shkolla, duke përfshirë edhe kualifikimet e reja.
- **Rekomandim Nr. 4 (kriter bazë 1.2.2.3)**
Në planin vjetor 2026-2027 duhet të hartohen objektiva specifike për çdo kualifikim profesional që ofron shkolla, duke përfshirë edhe kualifikimet e reja profesionale.

- **Rekomandim Nr. 5 (kriter bazë 1.3.1.1)**
Të gjitha dokumentet zyrtare që do të hartohen në vijim duhet të plotësohen me numër protokollit dhe datë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për arkivat. Libri i protokollit të fillojë me fillimin e vitit kalendarik dhe jo të vitit shkollor.
- **Rekomandim Nr. 6 (kriter bazë 1.4.1.4)**
Raporti zyrtar i vetëvlerësimit të publikohet në faqen zyrtare të ofruesit ose në rrjetet sociale. Ky rekomandim të zbatohet për vitin shkollor aktual dhe në vijim.
- **Rekomandim Nr. 7 (kriteret bazë 1.6.3.2; 4.5.1.1)**
Të adresohet pranë institucioneve përkatëse kërkesa për pajisjen e institucionit me ashensor. Ky rekomandim të fillojë të zbatohet menjëherë, deri në pajisjen e shkollës me ashensor.
- **Rekomandim Nr. 8 (kriteret bazë 1.6.3.4; 4.3.2.1)**
Për vitin shkollor 2026–2027 dhe në vijim, shkolla të marrë masa për të siguruar materiale për realizimin e praktikës në kabinetin e praktikës profesionale për kualifikimin “Shërbim Social dhe Shëndetësor”, për të ofruar kushte optimale për realizimin efektiv të praktikës për këtë kualifikim.
- **Rekomandim Nr. 9 (kriter plotësues 1.6.3.7)**
Rekomandohet pasurimi i fondit të bibliotekës me libra profesionalë dhe të rritet frekuentimi nga nxënësit dhe mësuesit duke filluar nga viti mësimor 2026-2027 dhe në vijim.
- **Rekomandim Nr. 10 (kriter bazë 1.6.4.1)**
Rekomandohet pajisja e shkollës me kopje të të gjitha autorizimeve të shëndetit publik të lëshuara nga autoritetet kompetente, për mjediset e praktikës profesionale që ofrohen në partneritet me biznesin. Ky rekomandim të zbatohet për vitin mësimor 2026-2027 e në vijim.
- **Rekomandim Nr. 11 (kriter bazë 1.6.4.2)**
Rekomandohet pajisja e shkollës me kopje të të gjitha autorizimeve të sigurisë të lëshuara nga autoritetet kompetente, për mjediset e praktikës profesionale që ofrohen në partneritet me biznesin. Ky rekomandim të zbatohet për vitin mësimor 2026-2027 e në vijim.
- **Rekomandimi Nr. 12 (kriter bazë 1.7.1.1)**
Për vitin shkollor 2026-2027 e në vijim drejtoria e shkollës duhet të vendosë në ambientet e shkollës kuti për mundësi ankese nga palët e interesuara.
- **Rekomandimi Nr. 13 (kriter bazë 1.7.1.2)**
Drejtoria e shkollës duhet të përmendë shprehimisht procedurat dhe afatet e ankimimit në çdo vendim që merr. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet menjëherë.

FUSHA 2. MARRËDHËNIA DHE BASHKËPUNIMI

- **Rekomandim Nr. 14 (kriter bazë 2.1.2.1)**

Duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, të formalizohet dhe dokumentohet në mënyrë sistematike procesi i raportimit pranë institucioneve të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, për të gjitha llojet e ofertave mësimore.

- **Rekomandim Nr. 15 (kriter bazë 2.2.1.1)**

Të përditësohet plani vjetor dhe afatmesëm i ofruesit të AFP-së duke identifikuar qartë partnerët dhe komunitetin e biznesit dhe të përshkruhen veprimtaritë e zhvilluara në bashkëpunim. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet menjëherë.

- **Rekomandim Nr. 16 (kriteret bazë 2.2.2.3; 2.2.2.4)**

Rekomandohet që në vijim të protokollohen të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit dhe kontratat e nxënësve që ndjekin kualifikimet profesionale në formën e dyfishtë të AFP-së. Ky rekomandim të fillojë të zbatohet menjëherë.

- **Rekomandim Nr. 17 (kriter bazë 2.2.2.5)**

Duke filluar nga shtatori 2026 dhe në vijim, rekomandohet të rritet bashkëpunimi me mentorët në biznese dhe të mblidhen të dhëna për pjesëmarrjen e tij në zbërthimin dhe planifikimin e përbashkët të planeve mësimore për nxënësit.

- **Rekomandim Nr. 18 (kriter bazë 2.3.1.1)**

Të përditësohet plani vjetor dhe afatmesëm i ofruesit të AFP-së, duke identifikuar qartë grupet e interesit dhe partnerët nga komuniteti dhe shoqëria civile. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet menjëherë.

- **Rekomandim Nr. 19 (kriter plotësues i papërmbyshur 2.3.1.3)**

Rekomandohet që shkolla të informojë rregullisht grupet e interesit, komunitetin vendas dhe shoqërinë civile mbi veprimtaritë, kualifikimet profesionale, si dhe certifikatat profesionale që ofron. Ky rekomandim të fillojë të zbatohet menjëherë.

- **Rekomandim Nr. 20 (kriter plotësues 2.3.1.4)**

Rekomandohet që shkolla të mbledhë rregullisht informacione nga shoqëria civile përmes anketave ose pyetësorëve mbi kënaqësinë, mbi veprimtarinë dhe rezultatet e ofrimit të AFP-së. Ky rekomandim të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2026-2027.

- **Rekomandim Nr. 21 (kriter plotësues 2.3.1.5)**

Duke filluar nga shtatori 2026, ofruesi i AFP-së të sigurojë që bashkëpunimi me organizatat e specializuara të shoqërisë civile, të jetë i strukturuar dhe i fokusuar në rritjen e regjistrimit dhe frekuentimit të nxënësve.

- **Rekomandim Nr. 22 (kriter bazë 2.4.1.1)**

Të përditësohet plani vjetor dhe afatmesëm i ofruesit të AFP-së, duke identifikuar qartë partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të AFP-së, donatorët dhe grupet e tjera të interesit. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet menjëherë.

- **Rekomandim Nr. 23 (kriteret plotësuese 2.4.1.3; 2.4.2.3)**

Shkolla duhet të ndërmarrë masa për zgjerimin, formalizimin dhe dokumentimin e partneriteteve zyrtare me ofruesit e tjerë të AFP-së dhe grupet e tjera të interesit. Ky rekomandim të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2026-2027.

- **Rekomandim Nr. 24 (kriter bazë 2.4.2.1)**

Të përditësohet plani vjetor dhe afatmesëm i ofruesit të AFP-së, duke identifikuar qartë partnerët dhe institucionet arsimore, veçanërisht institucionet arsimore nga të cilat regjistron/tërheq nxënës. Ky rekomandim duhet të fillojë të zbatohet menjëherë.

FUSHA 3. KURRIKULA E ZBATUAR.

- **Rekomandim Nr. 25 (kriter bazë 3.1.5.2)**

Shkolla duhet të ndërmarrë masa për formalizimin dhe dokumentimin e bashkëpunimit ndërmjet mësimeve dhe instruktorëve të bizneseve për hartimin e programit të praktikës profesionale. Ky rekomandim të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2026-2027.

FUSHA 4: MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

- **Rekomandimi Nr. 26 (kriter bazë 4.1.2.1)**

Duke filluar nga shtatori 2026, planet mësimore të praktikës profesionale për modulet që zhvillohen në biznes, duhet të nënshkruhen edhe nga instruktori i biznesit.

- **Rekomandimi Nr. 27 (kriter bazë 4.1.2.2)**

Nga qershori 2026 duhet të merren masa për reduktimin e lagështirës në mjediset e praktikës ku zhvillohet kualifikimi profesional “Hoteleri-Turizëm”.

- **Rekomandim Nr. 28 (kriter plotësues i papërbushur 4.4.1.1)**

Për vitin akademik 2026-2027, objektivat, materialet dhe strategjitë mësimore duhet të bazohen edhe në reagimet e marra nga grupet e interesit.

- **Rekomandim Nr. 29 (kriter plotësues i papërbushur 4.4.1.2)**

Për vitin akademik 2026-2027, mësimeve duhet të hartojnë dhe zbatojnë veprimtari mbështetëse përmirësuese, bazuar në rezultatet e vlerësimit të vazhduar dhe atij përfundimtar.

- **Rekomandim Nr. 30 (kriter bazë 4.5.1.1;)**

Për vitin akademik 2026-2027, shkolla duhet të realizojë instrumente vlerësimi (pyetësorë, intervista) me nxënësit me nevoja të veçanta, për të vlerësuar aksesin në mjedise dhe mbështetjen e përshtatshme për ta.

FUSHA 5: VLERËSIMI

- **Rekomandim Nr. 31 (kriter bazë 5.1.1.4)**

Mësimdhënësit duhet të dokumentojnë aktivitetet dhe rezultatet e vlerësimit individual dhe të njëri-tjetrit për nxënësit. Ky rekomandim të fillojë të zbatohet nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

- **Rekomandim Nr. 32 (kriter plotësues i papërmbushur 5.1.4.1)**

Duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, dhe në vazhdim shkolla duhet të konsultohet me përfaqësuesit e punëdhënësve për hartimin e instrumenteve të vlerësimit, kryesisht për vlerësimin e rezultateve të të nxënit me bazë punën, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

- **Rekomandim Nr. 33 (kriter plotësues i papërmbushur 5.1.4.2)**

Duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 dhe në vazhdim, shkolla duhet të përfshijë përfaqësues të punëdhënësve dhe bizneseve partnere, sipas kualifikimeve që ofrohen, në komisionet për vlerësimin e provimeve të praktikës profesionale sipas niveleve.

- **Rekomandim Nr. 34 (kriter plotësues i papërmbushur 5.1.4.3)**

Duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 dhe në vazhdim, drejtoria e shkollës duhet të informojë punëdhënësit dhe bizneset partnere për rezultatet e vlerësimeve përfundimtare.

VI. VENDIMI PËR AKREDITIM

Në bazë të raportit të akreditimit dhe propozimit të AKAFPK-së, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mori vendimin për **akreditim** për ofruesin publik të AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak”, Berat me Vendim nr. 252, datë 22.06.2026.

AKAFPK ka lëshuar certifikatën e akreditimit, me nr. serie 31, data 26.06.2026, me afat vlefshmërie deri më 21.06.2030.